

SHOQERI ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
BFI INVEST SH.P.K.
RR. PAPA GJON PALI II, ABA BUSINESS CENTER, KATI 11^{TË}, TIRANË, SHQIPËRI
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI
L51721007Q

VENDIM NR. 3

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me 20.12.2019, në selinë e Shoqërisë BFI Invest Sh.p.k., me NUIS L51721007Q ne adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA, Business Center, Tirane (më tej referuar si "Shoqëria"), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishëm:

- Shoqëria **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor, Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 025864525, dhe me numër personal I35203147R, ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% të kapitalit themeltar të saj.
- Z. Bers Hado, në cilësinë e asistentit ligjor të Shoqërisë Balfin Sh.p.k.

Meqenëse në mbledhje merr pjesë Ortaku që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë konsiderohet e mbledhur dhe vendimet e marra plotësisht të vlefshme.

Znj. Edlira MUKA e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, i cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE:

I. ZVOGËLIM I KAPITALIT TË SHOQËRISË BFI INVEST SH.P.K.

I. ZVOGËLIM I KAPITALIT TË SHOQËRISË BFI INVEST SH.P.K.

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikat e mësipërme të rendit të ditës, parashtron sa më poshtë:

Në lidhje me pikën e parë dhe të vetme në Rend të Ditës Kryetari i Asamblesë parashtron se, nga administratimi i Shoqërisë është propozuar zvogëlimi i kapitalit të saj me një vlerë prej 45,000,000 LEK (dyzetepesë milion Lekë). Kapitali aktual i Shoqërisë rezulton në një vlerë prej 50,000,000 LEK (pesëdhjetë milion Lekë), pas zvogëlimit kapitali i Shoqërisë do të ndryshojë në vlerën e re të barabartë me 5,000,000 LEK (pesë milion Lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI:

- a. Të miratojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me një vlerë të barabartë me 45,000,000 LEK (dyzetepesë milion Lekë).




- b. Sipas vendimit të marrë në pikën (a.) të këtij vendimi, kapitali i Shoqërisë pas zvogëlimit do të jetë në një vlerë të re të barabartë me 5,000,000 LEK (pesë milion Lekë)
- c. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë dhe/ose personat e autorizuar prej tij, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 12.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë **BFI INVEST SH.P.K.** mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", i ndryshuar.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
BFI INVEST SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA

SEKRETARI


Z. Bers HADO

